FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION
VENDIMET NGA MBLEDHJA E BORDIT TË FGJK-SË

Bordi Ekzekutiv (BE) i FGJK-së, me datë 06 Shkurt 2025 duke filluar nga ora 17:30, mbajti mbledhjen e parë të bordit në zyrën e FGJK-së, në Shtëpinë e Sportit në Prishtinë, duke ju përmbajtur rëndit të ditës.

REND I DITËS

1. **Hapja e mbledhjes nga Kryetari:** Mbledhja është hapur nga Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, i cili falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në këtë mbledhje.
2. **Caktimi i një proces-mbajtësi:** Kryetari Z. Maqastena propozoj që procesmbajtës në këtë mbledhje të jetë Sekretari i Përgjithshëm, Z. Amir Tahiraga, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.
3. **Verifikimi i pjesëmarrsëve në mbledhje, numri i tyre:** Në këtë pikë të rendit të ditës, u vërtetua se të gjithë anëtarët e BE të FGJK-së, ishin prezent në mbledhje, duke përfshirës edhe Sekretarin e Përgjithshëm, dhe mysafirin Z. Arlind Shaqirin.

   Të pranishëm në mbledhjë të BE të FGJK-së, ishin:

   1. Shkumbin Maqastena – Kryetar i FGJK-së,
   2. Besim Halilaj – Nënkryetar i FGJK-së,
   3. Sherife Aliçkaj Qerimi – Nënkryetare e FGJK-së,
   4. Elfete Gashi – Anëtare e BE të FGJK-së,
   5. Amir Januzi – Anëtar i BE të FGJK-së,
   6. Besnik Latifi – Anëtari BE të FGJK-së,
   7. Lisa Zeqiri – Anëtare e BE të FGJK-së,
   8. Rizonë Mustafa – Anëtare e BE të FGJK-së,
   9. Ard Kryeziu – Anëtar i BE të FGJK-së,
   10. Amir Tahiraga – Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së, pa të drejtë vote.
   11. Arlind Shaqiri – I ftuar në mbledhje të BE të FGJK-së pa të drejtë vote.
4. **Propozimi kandidatit për Sekretar të Përgjithshëm në bazë të statutit të FGJK-së, propozon kryetari e miraton Bordi Ekzekutiv -** Në këtë pikë Kryetari i FGJK-së, Z. Maqastena propozon që Sekretari aktual të vazhdoj me punë, dhe të gjithë anëtarët e BE të FGJK-së unanimisht votuan pro, nuk kishtë kundër apo abstenim, Z. Amir Tahiraga është Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së.
5. **Propozim kandidati për Sekretar Teknik të FGJK-së, votohet nga Bordi Ekzekutiv**, Kryetari i FGJK-së, Z. Maqastena propozon që Arlind Shaqiri të jetë Sekretar Teknik, duke theksuar që duhet të rritet kapaciteti në administrat të FGJK-së, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: info.kosova.gym@gmail.com

6. **Formimi i komisionieve që janë në kompetencë të bordit ekzekutiv:**
   a. **Komisioni disiplinor:** Për këtë komision janë propozuar tre emra: **Vlora Humolli Jashanica dhe Qendrësa Ramadani,** anëtarët e BE të FGJK-së, unanimisht votuan pro propozimit, dhe se për këtë komision nevojitet edhe një emër dhe se në mbledhjen e rradhës do të propozohet emri i tretë për të plotësuar numrin e komisionit disiplinor, deri atëherë komisioni do veproj vetëm me dy anëtarë.
   b. Komisionin e garave të FGJK-së: Për këtë komision janë propozuar këta emra: Abeliana Bregu, Ard Kryeziu, Doruntinë Ibrahimi, Sherife Qerimi, Besim Halilaj, dhe Amir Tahiraga, Arlind Shaqiri, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.
   c. **Komisioni për zgjedhjen e sportistit të vitit:** Për këtë Komision, anëtarët e BE të FGJK-së, vendosën që ky komision të funksionalizohet në fund të vitit, me çka të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.
   d. **Komisionin për regjistrimin e klubeve të reja dhe transferet e gjimnasteve/tëve nga klub në tjetrin:** Për këtë pikë u vendos që Sekretari i Përgjithshëm Z. Tahiraga dhe Sekretari Teknik Z. Shaqiri të jenë të ngarkuar më këtë punë të komisionit, të gjithë votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.
7. **Zgjedhja e Këshillit Profesional tre anëtarë ;** Për këtë Këshill u vendos unanimisht që të propozohen emrat në mbledhjet e ardhshme të BE të FGJK-së.
8. **Zgjedhja e Selektoreve/rëve, për gjimnastikë artistike për femra dhe meshkuj, dhe asistentët e tyre: Pas shumë debateve dhe diskutimeve, BE e FGJK-së, unanimisht vendosi që Z. Abeliana Bregu dhe Z. Doruntinë Ibrahimi të jenë selektore të FGJK-së për të gjitha grupmoshat.**
9. **Caktimi i datës për mbajtjen e Gjimnaestradës**: për datën e mbajtjes së Gjimnaestradës së FGJK-së, kishte shumë diskutimve, mirëpo është vendosur që me 22 Shkurt 2025 të mbahet gjimaestrada, të gjithe anëtarët ishin pro, nuk kishte kundër apo abstenim. **Vërejtje**: Për shkak të kohës së shkurtër, dhe pamundësisë së përgatitjes së klubeve për këtë event, ku edhe shumica e klubeve kërkuan që kjo garë të shtyhet, atëherë kërkesa për shtyerje të garës është diskutu në grupin e BE te FGJK-së, në aplikacionin vibër me datë 11 Shkurt 2025, ku edhe u kërkua që të votohet për datë të re dhe se është vendosur unanimisht që data për mbajtjen e Gjimnaestradës të jetë 15 Mars 2025, duke filluar nga ora 11:00, në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sporteve në Prishtinë.
10. **Të ndryshme:**

Në këtë pikë të rendit të ditës janë diskutuar shumë tema, është votu dhe aprovu paga e sekretarit të përgjithshëm dhe aprovu paga e sekretarit teknik, si dhe meditjet e jashtit dhe meditje brenda vendit gjatë organizimit të eventeve të ndryshme, gara, pritje zyrtare, etj, të gjithë të pranishmit votuan pro nuk kishte kundër apo abstenime.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: info.kosova.gym@gmail.com

VENDIMET NGA MBLEDHJA E BORDIT TË FGJK-SË

Sekretari i Përgjithshëm njoftoji të pranishmit se duke u bazuar në planin e aktiviteteve dhe financave të vitit 2024, FGJK është në proces të blerjës së disa veglave gjimnastikore nga kompania GYMNOVA, dhe se janë në negociata.

Mbledhja e BE të FGJK-së përfundoi me datë 06/02/2025 në ora 21:00

Sekretar i Pëgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: info.kosova.gym@gmail.com